

Prof. Dr. Albert Budiani



Prof. Dr. B. B.

Prof. Dr. B. B.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
SENATI AKADEMIK**

Nr. 2174 / Prot. 2

Vlorë më, 21.11.2023

VENDIM
Nr. 56 datë 21.11.2023

**PËR
MIRATIMIN E HAPJES SË PROGRAMIT TË RI TË STUDIMIT "BACHELOR NË
FIZIOTERAPI" PËR VITIN AKADEMIK 2024-2025**


Në mbështetje të nenit 25, pika 7, nenit 38, pika 1, shkronja dh, nenit 75 të Ligjit nr. 80/ 2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", nenit 10, pika 6, nenit 19, pika 1, shkronja ë të Statutit të Universitetit "Ismail Qemali", Vlorë, Udhëzimit nr.1 të MAS datë 14.01.2020, "Për dokumentacionin dhe procedurat për hapjen, riorganizimin dhe mbylljen e IAL-ve, degëve dhe njësive kryesore dhe programeve të studimit, si dhe për ndarjen ose bashkimin e IAL-ve", VKM nr. 41, datë 24.01.2018 "Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë" si dhe referuar propozimit të Zëvendësrektorit Akademik ardhur me shkresën 2144/1 prot, datë 20.11.2023 Senati Akademik në mbledhjen e tij të datës 21.11.2023,

VENDOSI:

1. Të miratojë propozimin e Departamentit të Kujdesit Shëndetësor në Fakultetin e Shëndetit për hapjen e programit të studimit "Bachelor në Fizioterapi" sipas materialit bashkëlidhur dhe pjesë e këtij vendimi.
2. Ngarkohet për zbatimin e këtij vendimi Fakulteti i Shëndetit, Departamenti i Kujdesit Shëndetësor, Zëvendësrektor Akademik, Drejtoria e Edukimit të Ciklit të parë dhe të dytë të studimit.
3. Ky vendim i përcillet për miratim të mëtejshëm Bordit të Administrimit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I SENATIT AKADEMIK
Prof.Dr. Roland Zisi





UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
ZV/REKTOR AKADEMIK

Nr. 2144 / Prot

Vlorë, më 20.11.2023

Lërca: Relacion për miratimin e celjes së programit të ri të studimit : "Bachelor në Fizioterapi", Fakulteti i Shëndetit në UV për vitin akademik 2024-2025.

PROF. DR. ROLAND ZISI
KRYETAR I SENATIT AKADEMIK

Me shkresën nr 2144 datë 17/11/2023, Fakulteti i Shëndetit në UV ka paraqitur për shqyrtim dhe miratim nga ana e Senatit Akademik, propozimin e Departamentit të Kujdesit Shëndetësor (Vendim departamenti nr. 153 datë 15.11.2023) për hapjen e programit të ri të studimit 'Bachelor në Fizioterapi' pranë Fakultetit të Shëndetit në UV.

Më poshtë ju përcjellim relacion të përmbledhur propozimit.

Programi që do të zhvillohet 'Bachelor në Fizioterapi' i përket fushës së shëndetit dhe kujdesit shëndetësor me përparësi në shëndetin publik, por duke përfshirë edhe aspekte të tjera të shërbimeve shëndetësore. Ky program synon rritjen e kapaciteteve profesionale në fushën e fizioterapisë. Ai ka për objektiv të përgatisë fizioterapeut të përgjithshëm me formim të plotë për të ofruar kujdes shëndetësor bazë për çdo patologji dhe për çdo grup-moshe (nga fëmijëria e deri në fund të moshës së tretë). Gjithashtu i përgatit studentët të realizojnë ndërhyrje bazë tek pacientët si dhe ndihmon në përmbushjen e detyrave bazë të kërkuara prej një fiziatër profesionist.

Studentët do të afësohen gjithashtu për të komunikuar në mënyrë profesionale edhe me publikun, duke tituar mjeshtri dhe përvojë në komunikimin formal dhe informal me studentë, fiziatër, infermierë, mjekë dhe specialistë të kujdesit shëndetësor.

Objektivat e këtij programi përfshijnë:

- * Afësimin sipas planeve bashkëkohore të asistencës profesionale në praktikën fizioterapeutike
- * Formimin e kompetencave fizioterapeutike (kuruese dhe rehabilituese) të bazuar në problem dhe praktikë.
- * Komunikimin efektiv me të tjerët.
- * Të menduarit kritik në gjykimet dhe vendim-marrjet profesionale.



UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË

ZV/REKTOR AKADEMIK

- Kontribuimin në rritjen e kapaciteteve shëndetësore komunitare.

Justifikimi i bazuar në të dhëna empirike dhe të verifikueshme për nevojën e hapjes të programit.

Baza ligjore e kërkesës për hapjen e Programit Bachelor në "Fizioterapi"

Departamenti i Kujdesit Shëndetësor - FSH propozon hapjen e Programit Bachelor në "Fizioterapi", duke u mbështetur në:


- Ligjin Nr.80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë" neni 70 / pika 4 "Ciklet dhe programet e studimeve",
- Kornizën Shqiptare të Kualifikimeve: Programe studimi Bachelor ,Diplomë universitare (niveli 6 i KSHK)
- Udhëzimin Nr.41, datë 24.01.2020 të MASH "Për elemente e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e Arsimit të Lartë",

Nevoja për hapjen e Programit Bachelor në "Fizioterapi"

Në kohën kur shëndeti dhe mirëqenia bëhen gjithnjë e më të rëndësishme në shoqëri, hapja e një programi Bachelor në "Fizioterapi" në Shqipëri do të hapte rrugën drejt përmirësimit të shërbimeve shëndetësore dhe promovimit të një stil jetese të shëndetshëm.

Nevoja për kujdesje shëndetësore fizioterapike diktohet prej shumë faktorësh:

- Në vitin 2021 jetëgjatësia në lindje u vlerësua në 74,4 vjet për meshkujt dhe 78,7 vjet për femrat dhe grup-mosha e popullsisë mbi 65 vjeç është rritur nga 11,0 % në vitin 2011 në 15,7 % në vitin 2022 sipas INSTAT.Kjo rritje e jetëgjatësisë rrit në mënyrë progresive nevojat për kujdesje shëndetësore fizioterapike pasi ekspozohen më shumë drejt sëmundjeve kockore, sindromit të rrëzimit dhe frakturave.
- Rritja e prevalences së aksidenteve rrugore me komplikacione që iniciojnë ndërhyrjen e fizioterapisë në mënyrë që të rifitojnë aftësitë fizike skeletike dhe të dalë sa më parë nga skema e invaliditetit.
- Komplikacione skeletike dhe neuro-muskulare të post-covid 19 rritja e numrit nga rastet e raportuara nga 8 qendrat fizioterapeutike në Vlorë.
- Mundësi formimi punësimi për profesionistët e rinj
- Tendanca për luftën kundër obezitetit.
- Aplikimi i terapive manuale dhe metodave të tjera për përmirësimin e cilësisë së jetës
- Problemet skeletike si dukuri aktuale e raportuar nga fizioterapistë egjistues janë dhe deformimet skeletike në moshat feminare.
- Edukimi shëndetësor për parandalimin e keq-qëndrimit në moshat e reja.
- Rritja e fluksit turistik në Vlorë rrit dhe kërkesat për trajtime fizioterapike.



UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË

ZV/REKTOR AKADEMIK

Aktualisht numri i profesionistëve të shëndetit në rajonin e jug-perëndimit (zona nën administrimin e Drejtorisë Rajonale të Operatorit të Shërbimeve të Kujdesit Shëndetësor Vlorë) si fizioterapeut është jashtëzakonisht minimal: vetëm 3 Fizioterapeutë në Spitalin e Vlorës, 3 në Spitalin e Fierit, ndërsa në investimin e ri të qeverisë turke në Fier, që është Spitali Rajonal Memorial Fier nuk ka fizioterapeut. Kemi numër të limituar edhe në Spitalet e tjera Rajonale ku në Gjirokastrë nuk ka staf si fizioterapeut dhe në Përmet është vetëm një prej tyre. Në total janë 7 vende pune për fizioterapistë, vetëm në tre rrethe, konkretisht në Vlorë, Fier dhe në Përmet. Ndërsa në gjashtë rrethe nuk ka asnjë fizioterapistë të punësuar në spitalet shtetërore (Sarandë, Tepelenë, Mallakastër, Lushnje dhe Delvinë). Vetëm në Qarkun Vlorë janë të licensuar 24 Fizioterapistë për vitin 2022, numër ky i cili tregon se sa pak profesionistë janë në këtë fushë. Duke u nisur nga pozicioni gjeografik i qytetit, problematikat shëndetësore, nevojës për profesionistë të tillë në Spitalet Rajonale, klinika private fizioterapie, palestrash, klube sportive të të gjitha sporteve, lind nevoja e zhvillimit të mëtejshëm dhe rishikim të planit mësimor/kurrikulave të programit në nivel masteri profesional, i cili të përgatisë profesionistë të mirëfilltë në fushën e fizioterapisë dhe rehabilitimit.

Një program Bachelor në "Fizioterapi" do të siguronte një bazë thelbësore të njohurive dhe aftësive për studentët që dëshirojnë të ndërtojnë karrierën e tyre në këtë fushë. Një trajnim i specializuar në anatomani, fiziologji, metodave terapeutike, dhe njohuri të tjera relevante do të përgatisin studentët për sfidat e punës në këtë sektor të rëndësishëm shëndetësor.

Një tjetër arsye për hapjen e këtij programi është nevoja për të përmbushur kërkesat e tregut të punës. Me rritjen e ndërgjegjësimit për shëndetin dhe mirëqenien, kërkesa për shërbime fizioterapeutike është shtuar. Duke ofruar një program të specializuar, Shqipëria do të ketë mundësinë të prodhojë një numër më të madh të profesionistëve të kualifikuar në këtë fushë, duke përmirësuar kështu kapacitetin e vendit për të përgjigjur ndaj nevojave të rritura të popullsisë.


Në përfundim, hapja e një programi Bachelor në "Fizioterapi" në Shqipëri është e nevojshme për të adresuar boshllëkun aktual në sistemin arsimor, për të përgatitur profesionistë cilësorë në fushën e shëndetit dhe për të përmirësuar shërbimet shëndetësore në vend. Kjo mund të sjellë përfitime të shumta, duke përfshirë rritjen e nivelit të shëndetit të popullsisë, përmirësimin e cilësisë së jetës së pacientëve, dhe kontributin në zhvillimin e sektorit shëndetësor në përgjithësi. Për sa më sipër, kërkojmë nga Senati akademik të miratojë celjen e këtij program të ri studimi.

Bashkëlidhur sekresa e Fakultetit të Shëndetit.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin!

ZV/REKTOR AKADEMIK

Prof. As. Frosina Qyrdeti



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI 'ISMAIL QEMALI' VLORE
FAKULTETI I SHËNDETIT
DEKANE

1144
17.11.2023

Nr. 53/2 prot.

Vlorë, më 16.11.2023

Lënda: Shkresë përcjellëse për projekt- propozimin për hapjen e programit Bachelor në
"Fizioterapi"

PROF.DR.ROLAND ZISI
REKTORIT TË UNIVERSITETIT

KËTU

I nderuar Z.Rektor,

Bashkangjitur po Ju dërgoj projekt - propozimin e Departamentit të Kujdesit Shëndetësor
për hapjen e programit Bachelor në "Fizioterapi", për ndjekjen eprocedurave të mëtejshme.

Duke Ju falenderuar për baskëpunimin,

DEKANE E FAKULTETIT TË SHËNDETIT

PROF.ASOC.AURELA SALIAJ



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI 'ISMAIL QEMALI' VLORE
FAKULTETI I SHËNDETIT
DEPARTAMENTI I KUJDESIT SHËNDETËSOR

Nr. 153/1 prot.

Vlorë, më 15. 11. 2023

VENDIM
I DEPARTAMENTIT TË KUJDESIT SHËNDETËSOR

Nr.19, datë 15-11-2023

PËR

“HAPJEN E PROGRAMIT BACHELOR NË “FIZIOTERAPI”

Departamenti i Kujdesit Shëndetësor – FSH i mbledhur sot më datë 15.11.2023 shqyrtoi programin e propozuar nga grupi i punës i Departamentit të Kujdesit Shëndetësor, (i ngritur me Urdhër të Drejtueses së Departamentit të Kujdesit Shëndetësor me Nr. 153 Prot., dt 20.06.2023, Bachelor në “Fizioterapi”.

Ky propozim mbështetet në:

- Ligjin Nr.80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë” neni 70 pika 4 “Ciklet dhe programet e studimeve”,
- Kornizën Shqiptare të Kualifikimeve: Programe studimi Bachelor ,Diplomë universitare (niveli 6 i KSHK)
- Udhëzimin Nr.41, datë 24.01.2020 të MASH “Për elemente e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e Arsimit të Lartë”,
- Listën Kombëtare të Profesioneve nga Agjensia e Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve, (<http://www.akafp.gov.al/teknike-dhe-specialiste-ne-zbatim/>)

Propozimi është një zbatim konkret i Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm 3 (Për shëndet të mirë dhe Mirëqenie), OZHQ 4 (Sigurimi i arsimit cilësor gjithëpërfshirës dhe mësim për të gjithë) e OZHQ 8 (Punësim i denjë dhe rritje ekonomike); si dhe detyrave që shtrohen nga Agjensia Kombëtare e Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve për zgjerimin e sistemit nëpërmjet zgjerimit të njësive ekzistuese, duke u ofruar mundësi më të mëdha zgjedhjeje maturantëve që duan të operojnë në fushën e shëndetit, si dhe sigurimit të shumëllojshmërisë së ofertave të formimit, në përputhje me nevojat e zhvillimit perspektiv të vendit.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**UNIVERSITETI 'ISMAIL QEMALI' VLORE
FAKULTETI I SHËNDETIT
DEPARTAMENTI I KUJDESIT SHËNDETËSOR**

Qëllimi kryesor i Diplomës Bachelor në “Fizioterapi” është të përgatisë fizioterapeut të përgjithshëm me formim të plotë për të ofruar kujdes shëndetësor bazë për çdo patologji dhe për çdo grup-moshe (nga fëmijëria e deri në fund të moshës së tretë).

Departamenti i Kujdesit Shëndetësor vlerësoi se:

Propozimi për hapjen e Diplomës Bachelor në “Fizioterapi” është mbështetur në plotësimin e kriterëve strukturore, organizative dhe ato për personelin akademik, në bashkëpunimin institucional me Bashkinë Vlorë, Institucionet Shëndetësore Parësore dhe dytësore Vlorë dhe Fier dhe Qëndrave të Fizioterapisë Vlorë dhe Fier.


Në përfundim Departamenti i Kujdesit Shëndetësor

VENDOSI:

1. Miratimin e propozimit të grupit të punës për hapjen e programit Bachelor në Fizioterapi
2. Përcjelljen e programit të propozuar tek Dekania e FSH për ndjekjen e procedurave të mëtejshme.

DREJTUESE E DEPARTAMENTIT TË KUJDESIT SHËNDETËSOR

PhD(C) Emirjona Këçaj



UNIVERSITETI 'ISMAIL QEMALI'
FAKULTETI I SHËNDETIT
DEPARTAMENTI I KUJDESIT SHËNDETËSOR

PROJEKT-PROPOZIM PËR HAPJEN E PROGRAMIT TË STUDIMIT
BACHELOR në FIZIOTERAPI

1. Institucioni/IAL	Universiteti 'Ismail Qemali' Vlorë
2. Aplikimi	a. Program i ri
3. Emërtimi i programit të propozuar për hapje	Bachelor në "Fiziterapi"
4. Viti akademik i hapjes	Viti akademik 2024-2025
5. Të dhënat për aktin e akreditimit të IAL dhe/ose njësisë kryesore që ofron programin e studimit.	<i>Akreditimi i UV:</i> Vendim i ASCAL Nr. 50, dt. 27.11.2020 <i>Hapja e FSH (ish-FSHP):</i> Urdhër i MAS nr. 398, dt. 10.08.2011
6. Vendimi i miratimit nga Senati Akademik Vendimi i miratimit nga Bordi Administrimit	Vendim i Senatit Akademik të UV
	Vendimi i Bordit të Administrimit të UV
7. Nëse është një program i përbashkët	N/A
8. Programi ofrohet nga:	Departamenti i Kujdesit Shëndetësor Fakulteti i Shëndetit Kampusi/godina D



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI 'ISMAIL QEMALI'
FAKULTETI I SHËNDETIT
DEPARTAMENTI I KUJDESIT SHËNDETËSOR

SEKSIONI A:

TË DHËNA MBI PROGRAMIN E STUDIMIT: BACHELOR NË FIZIOTERAPI

Emërtimi i programit të studimeve ne Bachelor:	Bachelor në "Fizioterapi"
Cikli i studimeve:	Cikli i parë
Lloji i programit:	Bachelor
Njësia bazë:	Departamenti i Kujdesit Shëndetësor
Njësia kryesore:	Fakulteti i Shëndetit
Kohëzgjatja e studimeve (shprehur në vite):	3
Numri i krediteve minimale	180
Gjuha e studimit:	Shqip


Përshkrimi i përgjithshëm i programit, misionit, qëllimit dhe objektivave.

Programi që do të zhvillohet 'Bachelor në Fizioterapi' i përket fushës së shëndetit dhe kujdesit shëndetësor me përparësi në shëndetin publik, por duke përfshirë edhe aspekte të tjera të shërbimeve shëndetësore. Ky program synon rritjen e kapaciteteve profesionale në fushën e fizioterapisë. Ai ka për objektiv të përgatisë fizioterapeut të përgjithshëm me formim të plotë për të ofruar kujdes shëndetësor bazë për çdo patologji dhe për çdo grup-moshe (nga fëmijëria e deri në fund të moshës së tretë). Gjithashtu i përgatit studentët të realizojnë ndërhyrje bazë tek pacientët si dhe ndihmon në përmbushjen e detyrave bazë të kërkuara prej një ftiziatër profesionist.

Studentët do të aftësohen gjithashtu për të komunikuar në mënyrë profesionale edhe me publikun, duke fituar mjeshtëri dhe përvojë në komunikimin formal dhe informal me studentë, ftiziatër, infermierë, mjekë dhe specialistë të kujdesit shëndetësor.

Objektivat e këtij programi përfshijnë:

- Aftësimin sipas planeve bashkëkohore të asistencës profesionale në praktikën fizioterapeutike.
- Formimin e kompetencave fizioterapeutike (kuruese dhe reabilituese) të bazuar në problem dhe praktikë.
- Komunikimin efektiv me të tjerët.
- Të menduarit kritik në gjykimet dhe vendim-marrjet profesionale.
- Kontribuimin në rritjen e kapaciteteve shëndetësore komunitare.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI 'ISMAIL QEMALI'
FAKULTETI I SHËNDETIT
DEPARTAMENTI I KUJDESIT SHËNDETËSOR

Justifikimi i bazuar në të dhëna empirike dhe të verifikueshme për nevojën e hapjes të programit.

Baza ligjore e kërkesës për hapjen e Programit Bachelor në "Fizioterapi"

Departamenti i Kujdesit Shëndetësor - FSH propozon hapjen e Programit Bachelor në "Fizioterapi", duke u mbështetur në:

- Ligjin Nr.80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë" neni 70 / pika 4 "Ciklet dhe programet e studimeve",
- Kornizën Shqiptare të Kualifikimeve: Programe studimi Bachelor ,Diplomë universitare (niveli 6 i KSHK)
- Udhëzimin Nr.41, datë 24.01.2020 të MASH "Për elemente e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e Arsimit të Lartë",

Nevoja për hapjen e Programit Bachelor në "Fizioterapi"

Në kohën kur shëndeti dhe mirëqenia bëhen gjithnjë e më të rëndësishme në shoqëri, hapja e një programi Bachelor në "Fizioterapi" në Shqipëri do të hapte rrugën drejt përmirësimit të shërbimeve shëndetësore dhe promovimit të një stil jetese të shëndetshëm.

Nevoja për kujdesje shëndetësore fizioterapike diktohet prej shumë faktorësh:

- Në vitin 2021 jetëgjatësia në lindje u vlerësua në 74,4 vjet për meshkujt dhe 78,7 vjet për femrat dhe grup-mosha e popullsisë mbi 65 vjeç është rritur nga 11,0 % në vitin 2011 në 15,7 % në vitin 2022 sipas INSTAT.Kjo rritje e jetëgjatësisë rrit në mënyrë progresive nevojat për kujdesje shëndetësore fizioterapike pasi ekspozohen më shumë drejt sëmundjeve kockore, sindromit të rrëzimit dhe frakturave.
- Rritja e prevalences së aksidenteve rrugore me komplikacione që iniciojnë ndërhyrjen e fizioterapisë në mënyrë që të rifitojnë aftësitë fizike skeletike dhe të dalë sa më parë nga skema e invaliditetit.
- Komplikacione skeletike dhe neuro-muskulare të post-covid 19 rritja e numrit nga rastet e raportuara nga 8 qendrat fizioterapeutike në Vlorë.
- Mundësi formimi punësimi për profesionistët e rinj
- Tendenca për luftën kundër obezitetit.
- Aplikimi i terapive manuale dhe metodave të tjera për përmirësimin e cilësisë së jetës
- Problemet skeletike si dukuri aktuale e raportuar nga fizioterapistë egjistuese janë dhe deformimet skeletike në moshat feminare.
- Edukimi shëndetësor për parandalimin e keq-qëndrimit në moshat e reja.
- Rritja e fluksit turistik në Vlorë rrit dhe kërkesat për trajtime fizioterapike.

Aktualisht numri i profesionistëve të shëndetit në rajonin e jug-perëndimit (zona nën administrimin e Drejtorisë Rajonale të Operatorit të Shërbimeve të Kujdesit Shëndetësor Vlorë) si fizioterapeft është jashtëzakonisht minimal: vetëm 3 Fizioterapeftë në Spitalin e Vlorës, 3 në



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI 'ISMAIL QEMALI'
FAKULTETI I SHËNDETIT
DEPARTAMENTI I KUJDESIT SHËNDETËSOR

Spitalin e Fierit, ndërsa në investimin e ri të qeverisë turke në Fier, që është Spitali Rajonal Memorial Fier nuk ka fizioterapeft. Kemi numër të limituar edhe në Spitalet e tjera Rajonale ku në Gjirokastrë nuk ka staf si fizioterapeft dhe në Përmet është vetëm një prej tyre. Në total janë 7 vende pune për fizioterapistë, vetëm në tre rrethe, konkretisht në Vlorë, Fier dhe në Përmet. Ndërsa në gjashtë rrethe nuk ka asnjë fizioterapistë të punësuar në spitalet shtetërore (Sarandë, Tepelenë, Mallakastër, Lushnje dhe Delvinë). Vetëm në Qarkun Vlorë janë të licensuar 24 Fizioterapistë për vitin 2022, numër ky i cili tregon se sa pak profesionistë janë në këtë fushë.

Duke u nisur nga pozicioni gjeografik i qytetit, problematikat shëndetësore, nevojës për profesionistë të tillë në Spitalet Rajonale, klinika private fizioterapie, palestrash, klube sportive të të gjitha sporteve, lind nevoja e zhvillimit të mëtejshëm dhe rishikim të planit mësimor/kurrikulave të programit në nivel masteri profesional, i cili të përgatisë profesionistë të mirëfilltë në fushën e fizioterapisë dhe rehabilitimit

Një program Bachelor në "Fizioterapi" do të sigurojë një bazë thelbësore të njohurive dhe aftësive për studentët që dëshirojnë të ndërtojnë karrierën e tyre në këtë fushë. Një trajnim i specializuar në anatomi, fiziologji, metodave terapeutike, dhe njohuri të tjera relevante do të përgatisin studentët për sfidat e punës në këtë sektor të rëndësishëm shëndetësor.

Një tjetër arsye për hapjen e këtij programi është nevoja për të përmbushur kërkesat e tregut të punës. Me rritjen e ndërgjegjësimit për shëndetin dhe mirëqenien, kërkesa për shërbime fizioterapeutike është shtuar. Duke ofruar një program të specializuar, Shqipëria do të ketë mundësinë të prodhojë një numër më të madh të profesionistëve të kualifikuar në këtë fushë, duke përmirësuar kështu kapacitetin e vendit për të përgjigjur ndaj nevojave të rritura të popullsisë.

Në përfundim, hapja e një programi Bachelor në "Fizioterapi" në Shqipëri është e nevojshme për të adresuar boshllëkun aktual në sistemin arsimor, për të përgatitur profesionistë cilësorë në fushën e shëndetit dhe për të përmirësuar shërbimet shëndetësore në vend. Kjo mund të sjellë përfitime të shumta, duke përfshirë rritjen e nivelit të shëndetit të popullsisë, përmirësimin e cilësisë së jetës së pacientëve, dhe kontributin në zhvillimin e sektorit shëndetësor në përgjithësi.

Analiza SWOT e aplikimit për hapjen e programit të studimit

Forcat (Strengths):

1. Formimi i profesionistëve të rinj fizioterapeft do të vijë pas një historie të gjatë edukimi dhe formimi të infermierëve dhe infermieri-mamisë
2. Programe të konsoliduara akademike për përgatitjen e profesionistëve të rinj, të asistuar nga pedagogët dhe literatura.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI 'ISMAIL QEMALI'
FAKULTETI I SHËNDETIT
DEPARTAMENTI I KUJDESIT SHËNDETËSOR

3. Fakulteti i Shëndetit ka drejtime kërkimore të përcaktuara dhe vazhdimësi në projekte fizibiliteti specifike, për të cilat ka marr financime nga institucione kombëtare dhe ndërkombëtare.
4. Struktura akademike dhe administrative, e ngritur për programin Bachelor në Fizioterapi është gati pasi ajo shërben edhe për dy programet ekzistuese në Fakultetin e Shqëndetit.
5. Nevoja e Rritur për Fizioterapi: Ekziston një nevojë e rritur për trajnues të kualifikuar në fushën e Fizioterapisë, duke pasuar rritjen e ndërgjegjësimit për shëndetin dhe mirëqenien fizike.
6. Ndikimi Pozitiv në Shëndetin Publik: Programi do të ofronte një kontribut të rëndësishëm në promovimin e shëndetit publik dhe në trajtimin e sëmundjeve dhe dëmtimeve të ndryshme.
7. Baza e Ndërgjegjësuar e Studentëve: Ka një bazë të lartë të studentëve të interesuar për të ndjekur një program studimi në Fizioterapi, duke krijuar një mundësi të mirë për punësim.

Dobësitë (Weaknesses):

Mungesa e Kualifikimit: Mund të ketë mungesë të kualifikuarve docentë dhe instruktorëve me përvojë edukative në këtë fushë. Rekrutimi i pedagogëve fizioterapeftë do jetë sfidues, pasi kjo disiplinë ofrohet për herë të parë në Rajonin e Jugut një fushë e tillë studimore.

Mundësitë (Opportunities):

1. Bashkëpunimi me Universitetin e Janinës, që ka një përvojë shumëvjeçare në formimin e infermiereve dhe ofron praktikisht standartin më të lartë në këtë fushë në Republikën e Shqipërisë, do tu mundësojë praktika të mirëfillta dhe shkëmbime studentësh gjatë studimeve edhe në fushën e Fizioterapisë.
2. Ndikim Pozitiv në Kulturën Shëndetësore: Programi mund të ndihmojë në ndryshimin e kulturës shëndetësore në vend, duke rritur ndërgjegjësimin për rëndësinë e parandalimit dhe trajtimit të sëmundjeve përmes fizioterapisë.
3. Bashkëpunimi me Institucione Shëndetësore: Mundësia për bashkëpunim me institucione shëndetësore lokale dhe kombëtare për ofrimin e praktikave dhe trajnimit të terrenit.
4. Rritja e Kërkesës për Profesionistë: Një rritje e pritshme e kërkesës për profesionistë të kualifikuar në këtë fushë në tregun e punës lokal dhe ndërkombëtar.

Rreziqet (Threats):

1. Konkurrenca nga Programe të Tjera: Mund të ketë konkurrencë nga programe të ngjashme në vende tjera, duke kërkuar një strategji të qëndrueshme për të mbajtur studentët në Shqipëri.
2. Ndryshime në Kërkesat e Licencimit: Ndërhyrjet e mundshme nga autoritetet e arsimit dhe shëndetit për ndryshime në kërkesat e licencimit dhe akreditimit mund të sjellin sfida të papritura.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI 'ISMAIL QEMALI'
FAKULTETI I SHËNDETIT
DEPARTAMENTI I KUJDESIT SHËNDETËSOR

SEKSIONI B:

**TË DHËNA MBI KRITERET E PRANIMIT NË KËTË PROGRAM STUDIMI,
TARIFAT DHE MODALITETET FINANCIARE PËR STUDENTËT**

Kriteret e pranimit në programin e studimit.

Diploma e maturës

Numri maksimal i studentëve që do të pranohen.

40 studentë

Tarifa e studimit.


40,000 L / vit

Politika e mbështetjes financiare për studentët (llojet e bursave nëse ka).

Kategoritë në nevojë dhe studentët ekselentë do të jenë të përjashtuar nga tarifa e studimit.

Kuota të dedikuara për studentë të kategorive të veçanta.

2 kuota për kategoritë e marginalizuara.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI 'ISMAIL QEMALI'
FAKULTETI I SHËNDETIT
DEPARTAMENTI I KUJDESIT SHËNDETËSOR

SEKSIONI C:

PLANI MËSIMOR/KURRIKULA E PROGRAMIT TË STUDIMIT

Ndarja e moduleve sipas veprimtarive formuese				
		Kodi	Lënda	Kreditet
Lëndë bazë: A (27 kredite)	1.		Metodat e kërkimit në Fizioterapi	4
	2.		Terminologji mjekësore	4
	3.		Biomekanika dhe Kinezologjia	4
	4.		E drejta e punës dhe Legjislacioni shëndetësor	4
	5.		Principet bazë të Infermierisë	11
Lëndë karakterizuese: B (98 kredite)	6.		Psikologjia e Reabilitimit dhe Komunikimi	6
	7.		Anatomi humane	16
			Anatomi humane I	
			Anatomi humane II	
	8.		Metodologjia e reabilitimit terapi manuale	6
	9.		Metoda dhe teknika të reabilitimit motorik	6
	10.		Fizioterapia muskuloskeletale	6
	11.		Fizioterapi instrumentale	6
	12.		Planifikimi i trajtimeve afatgjata	4
	13.		Rehabilitimi në sëmundje të brendshme	4
	14.		Rehabilitimi në traumatologji	4
	15.		Rehabilitimi në sëmundjet neurologjike	4
	16.		Rehabilitim në geriatri	4
	17.		Rehabilitim në pediatri	4
	18.		Menaxhimi i dhimbjes dhe reabilitimi	6
	19.		Mjekësi sportive	6
	20.		Neurologji	4
	21.		Traumatologji	4
	22.		Kujdes palativ	4
	23.		Sëmundje e brendshme	4
Lëndë ndërdisiplinore / integruese: C (28 kredite)	24.		Fiziologji dhe Fizpatologji	8
	25.		Farmakologji	8
	17		Geriatri	6
			Gjenetikë mjekësore	
	18		Reumatologji	6
			Pediatri	
Lëndë plotësuese: D (21 kredite)	19		Teknologji informacioni dhe komunikimi	4
	20		Anglisht	4
			Gjermanishte	
			Italishte	



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI 'ISMAIL QEMALI'
FAKULTETI I SHËNDETIT
DEPARTAMENTI I KUJDESIT SHËNDETËSOR

	22		Praktika profesionale	13
Detyrimet përmbyllëse: E (6 Kredite)	23		Pregatitje për provim final / temë diplome	6
Total				180



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI 'ISMAIL QEMALI'
FAKULTETI I SHËNDETIT
DEPARTAMENTI I KUJDESIT SHËNDETËSOR

SEKSIONI D:
PERSONELI AKADEMIK DHE NDIHMËS AKADEMIK

Numri i personelit akademik në njësinë bazë.	11
Numri i personelit akademik që i dedikohet programit të studimit (personel me kohë të plotë/pjesshme).	30
Numri i personelit akademik të përfshirë në lëndët karakterizuese (personel me kohë të plotë/pjesshme)	15
Numri i personelit ndihmës akademik me karakter mësimor në funksion të programit të studimit	2
Nëse programi i propozuar është inter-disiplinor, identifikoni personelin akademik që vjen nga departamente apo fakultete të tjera: ○ Gjuhë e huaj ○ Teknologji informacioni ○ Fizikë	4

CV-të e shkurtuara të personelit akademik që do të angazhohen në program (titulli/grada, fusha e ekspertizës kërkimore), angazhimin në program të personaliteteve të spikatura të fushës së studimit, etj.


Yllka Stramarko <i>Kategoria:</i> Profesor <i>Grada shkencore:</i> Profesor Doktor <i>Fusha e ekspertizës:</i> Mjeke familjeje, Shëndet Publik
Aurela Saliaj <i>Kategoria:</i> Profesor <i>Grada shkencore:</i> Profesor Doktor <i>Fusha e ekspertizës:</i> Mjeke pediatre
Majlinda Zahaj <i>Kategoria:</i> Lektore <i>Grada shkencore:</i> Doktore Shkencash <i>Fusha e ekspertizës:</i>



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI 'ISMAIL QEMALI'
FAKULTETI I SHËNDETIT
DEPARTAMENTI I KUJDESIT SHËNDETËSOR


Mjeke mikrobiologe, Farmakologji klinike
Vitori Hasani <i>Kategoria:</i> Profesor <i>Grada shkencore:</i> Profesore e asocijuar <i>Fusha e ekspertizës:</i> Mjeke higjeniste, Shëndet Publik
Afërdita Nikaj <i>Kategoria:</i> Lektore <i>Grada shkencore:</i> Doktore Shkencash <i>Fusha e ekspertizës:</i> Mjeke patologe, Shëndet Publik
Jerina Celaj <i>Kategoria:</i> Asistent-lektore <i>Grada shkencore:</i> PhD në proces <i>Fusha e ekspertizës:</i> Mjeke e përgjithshme
Fatjona Kamberi <i>Kategoria:</i> Lektore <i>Grada shkencore:</i> Profesore e asocijuar <i>Fusha e ekspertizës:</i> Infermiere e përgjithshme
Rezarta Lalo <i>Kategoria:</i> Lektore <i>Grada shkencore:</i> Profesore e asocijuar <i>Fusha e ekspertizës:</i> Infermiere e përgjithshme, OBS
Emirjona Kiçaj <i>Kategoria:</i> Asistent-lektore <i>Grada shkencore:</i> PhD në proces <i>Fusha e ekspertizës:</i> Infermiere e përgjithshme
Evis Alushi <i>Kategoria:</i> Lektore <i>Grada shkencore:</i> Doktore Shkencash <i>Fusha e ekspertizës:</i> Infermiere e përgjithshme
Stiliana Brokaj <i>Kategoria:</i> Asistent-lektore <i>Grada shkencore:</i> Master i Shkencave



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI 'ISMAIL QEMALI'
FAKULTETI I SHËNDETIT
DEPARTAMENTI I KUJDESIT SHËNDETËSOR

<i>Fusha e ekspertizës:</i> Infermiere e përgjithshme
Rudina Çerçizaj <i>Kategoria:</i> Asistent-lektore <i>Grada shkencore:</i> PhD në proces <i>Fusha e ekspertizës:</i> Infermiere e përgjithshme
Sonila Nikaj <i>Kategoria:</i> Asistent-lektore <i>Grada shkencore:</i> PhD në proces <i>Fusha e ekspertizës:</i> Infermiere e përgjithshme, Shëndet mendor
Eljona Proko <i>Kategoria:</i> Lektore <i>Grada shkencore:</i> Doktore Shkencash <i>Fusha e ekspertizës:</i> Teknologji Informacioni
Kozeta Hyso <i>Kategoria:</i> Profesor <i>Grada shkencore:</i> Profesore e asocijuar <i>Fusha e ekspertizës:</i> Gjuhë e huaj



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI 'ISMAIL QEMALI'
FAKULTETI I SHËNDETIT
DEPARTAMENTI I KUJDESIT SHËNDETËSOR

SEKSIONI E:

INFRASTRUKTURA AKADEMIKE NË FUNKSION TË PROGRAMIT

Numrin dhe sipërfaqet e auditorëve.

Fakulteti i Shëndetit ka në dispozicion të 1000 studentëve të tij rreth 3200 m² sipërfaqe, që shfrytëzohet në 2 fasha orare. Orët teorike të programit studimor Fizioterapi do të kryhen në ambjentet e Godinës D të Universitetit 'Ismail Qemali' Fakulteti i Shëndetit. Në dispozicion të formimit teorik të studentëve të këtij programi studimor janë:

- ☛ 2 klasa seminaresh (kapaciteti 25-30 poste)
- ☛ 1 klasë leksionesh (kapaciteti 80 poste)
- ☛ 1 sallë takimesh për prezantime në dërrasë interaktive (kapaciteti 25 poste)
- ☛ 1 sallë konferencash për prezantimin e punimeve shkencore (kapaciteti 200 poste).

Laboratorët dhe mjediset për realizimin e praktikës profesionale.

Fakulteti i Shëndetit disponon laboratorë didaktikë dhe manikinë simulatore në fushën e shëndetit, si edhe një laborator biokimik-mikrobiologjik të dedikuar për mbështetjen e kërkimeve shkencore në fushën e shëndetit. Laboratori është i mirëpajisur me aparatura bashkëkohore dhe me personel të licencuar në dispozicion.

Praktika profesionale do të realizohet në disa qendra reabilituese në qytetin e Vlorës dhe Fierit, si dhe Spitalet rajonale të këtyre qyteteve.

Bibliotekën, numrin e titujve, numrin e posteve të leximit, e-library

UV vë në dispozicion të studentëve bibliotekën e cila ndodhet në godinën A dhe një degë në godinën B. Biblioteka në godinën A ka sipërfaqe 250 m², me kapacitet 70 vende dhe me një numër librash prej 4930 volume, kurse biblioteka në godinën B ka një sipërfaqe 60 m² me kapacitet 30 vende dhe 1350 volume. Studentët e UV kanë akses online në JSTORE dhe U-library RASH. Gjithashtu, sipas marrveshjes me Hellenic Mediterranean University – Greece, studentët e Fizioterapisë së Fakultetit të Shëndetit do të kenë akses në bibliotekën online të këtij universiteti për kryerjen e studimeve review dhe research të literaturës.


Zyra për stafin akademik dhe ndihmës akademik.

Stafi akademik:

- 1 zyrë për drejtuesen e departamentit
- 1 zyrë për stafin akademik
- 1 zyrë për koordinatoren e praktikave

Stafi ndihmës-akademik:

- 1 zyrë për laborantet
- 1 zyrë për sekretarinë mësimore
- 1 zyrë për shërbimin ndaj studentëve




REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI 'ISMAIL QEMALI'
FAKULTETI I SHËNDETIT
DEPARTAMENTI I KUJDESIT SHËNDETËSOR

SEKSIONI F:

PROGRAMET E PËRBASHKËTA

Programi Bachelor në Fizioterapi në Fakultetin e Shëndetit, kërkuar nga Departamenti i Kujdesit Shëndetësor – Universiteti i Vlorës nuk është program i përbashkët me departamente, fakultete apo universitet të tjera.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI 'ISMAIL QEMALI'
FAKULTETI I SHËNDETIT
DEPARTAMENTI I KUJDESIT SHËNDETËSOR

SEKSIONI G:

ANALIZË E TREGUT TË PUNËS

Ndryshimi dhe avantazhet potenciale të programit të propozuar për hapje në lidhje me programet e ngjashme të studimit të ofruar nga IAL të tjera.

Programi i propozuar është i mirëstrukturuar për të rritur kompetencat e studentëve në të gjitha aspektet e fushës së formimit dhe është bazuar në eksperiencën e gjatë të Fakultetit të Shëndetit në formimin e profesionistëve të rinj në dy fusha studimi dhe në përvojën disa vjeçare të këtij fakulteti në formimin profesional duke shfrytëzuar maksimalisht kapacitetet laboratorike, praktike e teorike të formimit të posatshtëm studentor.

Nga ana tjetër duke qënë se Rajoni Jug-Lindor është në nivele nën minimalen e mbulimit shëndetësor me fizioterapeft tregu i punës ka tregues se subjektet private që ofrojnë vendqëndrime (resorte dhe hoteleri) për turistët po rekrutojnë jashtë kufijve për të plotësuar nevojat. Kjo përbën një arsye të fortë përse Fakulteti i Shëndetit si një ndër arteriet më të mëdha të universitetit, por edhe se gëzon një eksperiencë të gjatë e të suksesshme, të çelë një program të ri studimi për formimin e fizioterapefteve.

Gjithashtu, kjo risi fushe studimore do të ulte shpenzimet e studimit për studentët që largohen nga Rajoni i Jugut shumë më larg banesës. Nderkohë që transporti është rregulluar për qytetet si Fieri, Lushnja e Mallakastra që studiojnë në Universitetin e Vlorës. Rritja e numrit të studentëve do të rriste progresivisht edhe të ardhurat për universitetin.

Trendi vendas dhe rajonal i punësimit në sektorin ku bën pjesë programi i studimit, referuar burimeve zyrtare si INSTAT, Ministria e Financave dhe Ekonomisë, organizma ndërkombëtarë, etj.

Aktualisht numri i profesionistëve të shëndetit në rajonin e jug-perëndimit (zona nën administrimin e Drejtorisë Rajonale të Operatorit të Shërbimeve të Kujdesit Shëndetësor Vlorë) si fizioterapeft është jashtëzakonisht minimal: vetëm 3 Fizioterapeftë në Spitalin e Vlorës, 3 në Spitalin e Fierit, ndërsa në investimin e ri të qeverisë turke në Fier, që është Spitali Rajonal Memorial Fier nuk ka fizioterapeft. Kemi numër të limituar edhe në Spitalet e tjera Rajonale ku në Gjirokastrë nuk ka staf si fizioterapeft dhe në Përmet është vetëm një prej tyre. Në total janë 7 vende pune për fizioterapistë, vetëm në tre rrethe, konkretisht në Vlorë, Fier dhe në Përmet. Ndërsa në gjashtë rrethe nuk ka asnjë fizioterapistë të punësuar në spitalet shtetërore (Sarandë, Tepelenë, Mallakastër, Lushnje dhe Delvinë). Vetëm në Qarkun Vlorë janë të licensuar 24 Fizioterapistë për vitin 2022, numër ky i cili tregon se sa pak profesionistë janë në këtë fushë.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI 'ISMAIL QEMALI'
FAKULTETI I SHËNDETIT
DEPARTAMENTI I KUJDESIT SHËNDETËSOR

Duke u nisur nga pozicioni gjeografik i qytetit, problematikat shëndetësore, nevojës për profesionistë të tillë në Spitalet Rajonale, klinika private fizioterapie, palestrash, klube sportive të gjitha sportive, lind nevoja e zhvillimit të mëtejshëm dhe rishikim të planit mësimor/kurrikulave të programit në nivel masteri profesional, i cili të përgatisë profesionistë të mirëfilltë në fushën e fizioterapisë dhe rehabilitimit

Nevoja e pa përmbushur e tregut të punës që plotëson programi i ri i propozuar nga IAL-ja.

Nevojat Lokale:

Trajtimi i popullsisë së plakur: Fizioterapia është e rëndësishme për përmirësimin e shëndetit të popullsisë së plakur, duke ofruar trajtime dhe programe rehabilitimi për problemet e lidhura me moshën, duke përfshirë çështjet e mobilizimit dhe uljes së dhimbjeve.

Ndihma për personat me dëmtime fizike: Në nivele lokale, ekzistojnë nevoja të mëdha për trajtimin e individëve me dëmtime fizike, të cilët mund të përfitojnë nga terapi të fizioterapeutike për rikuperim dhe përmirësim të funksionimit të tyre motorik.

Nevojat Kombëtare:

Përmirësimi i Sistemit Shëndetësor: Në nivel kombëtar, një program i fortë i Fizioterapisë mund të kontribuojë në përmirësimin e efikasitetit të sistemit shëndetësor, duke zvogëluar barrën e sëmundjeve kronike dhe rikuperuar pacientët më shpejt nga dëmtimet.

Reduktimi i Kostove Shëndetësore: Trajtimet fizioterapeutike mund të ndihmojnë në reduktimin e kostove shëndetësore në nivel kombëtar duke parandaluar komplikime të mundshme dhe sëmundje afatgjate.

Rajonal:

Bashkëpunimi Nderkombëtar për Zhvillim Profesional: Në një kontekst ndërkombëtar, bashkëpunimi në fushën e Fizioterapisë mund të kontribuojë në shkëmbimin e njohurive dhe praktikave më të mira, duke përmirësuar standartet profesionale dhe trajnimin e praktikantëve. Ndihma në Situata Emergjente dhe Kthjellimi i Përvojave: Në raste të situatave emergjente apo ngjarjeve katastrofike ndërkombëtare, fizioterapistët mund të luajnë një rol kyç në ofrimin e ndihmës dhe rehabilitimit për individët e prekur.

Strukturat në dispozicion të studentëve për të bërë ndërlidhjen me tregun e punës si dhe burimet financiare në dispozicion të këtyre strukturave.

Zyra e këshillimit akademik në Fakultetin e Shëndetit dhe Zyra e Alumnit në Universitetin e Vlorës.

Punësimi potencial i studentëve.

Klinikat fizioterapeutike dhe Spitalet dytësore dhe tretësore.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI 'ISMAIL QEMALI'
FAKULTETI I SHËNDETIT
DEPARTAMENTI I KUJDESIT SHËNDETËSOR

Marrëveshje me institucionet publike dhe jopublike, të cilat mund të asistojnë në përmbushjen e kërkesave më të mira të programit Bachelor në Fizioterapi

- o Hellenic Mediterranean University (Marrëveshje datë 07-01-2021 HMU dhe datë 23-12-2020 UV, article II / 2,3,5,6,12,13)
- o Departamenti i Shëndetit Publik – Universiteti i Mjekësisë, Tiranë. Marrëveshje Nr.2540 Prot.,dt.25-11-2020 (DSHP-UMT) dhe Nr.272 Prot.,dt.10-12-2020 (FSH-UV)
- o Spitali Memorial Fier (Nr.611/32 Prot.,dt.22-09-2022)
- o Drejtorisë Rajonale Vlorë të Operatorit të Shërbimeve të Kujdesit Shëndetësor (Marrëveshje Nr.997 Prot.,dt.17-06-2019)
- o Drejtorisë së Spitalit Rajonal Vlorë (Marrëveshje Nr.68 prot., dt.07-10-2015).
- o Drejtorisë së Spitalit Rajonal Fier (Marrëveshje Nr.221 prot., dt.10-10-2017).
- o Spitalit Psikiatrik 'Ali Mihali' Vlorë (Marrëveshje Nr.1127 prot., dt.17-06-2019).
- o Universitetit të Mjekësisë, Tiranë (Nr.2509 Prot.,dt.29-12-2017)
- o Bashkia Vlorë (Nr.5240 Prot.,dt.17-06-2019)
- o Qendra "Verona" (Marrëveshje Nr.173 prot., dt.01-11-2023).
- o Qendra "Fiziolife" Vlorë (Marrëveshje Nr.173/1 prot, dt .01-11-2023).



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
REKTORI

Vlorë më, 17 .11 .2023

Lënda : Ngarkohen për zbatimin e shkresës bashkëlidhur në respektim të legjislacionit përkatës në fuqi :

Drejtuar:

- Senati
- Rektori
- Këshilli Etikës
- Rektori
 - Qendra Studimore e Zhvillimit Rajonal
 - Sektori Juridik
 - Drejtoria e Komunikimit dhe Burimeve Njerëzore
 - Sektori i Burimeve Njerëzore dhe Protokoll-Arkivës
 - Sektori i Komunikimit dhe Marrëdhënieve me Publikun
 - Sektori i IT-së
- Bordi i Administrimit
- Administrator
 - Drejtoria e Shërbimeve Mbështetëse
 - Sektori i Financës dhe Realizimit të Buxhetit
 - Sektori i Prokurimeve
 - Sektori i Shërbimeve
- Njësia e Auditit të Brendshëm
- Zv. Rektor për Kërkimin Shkencor dhe Zhvillimin Insitucional
 - Drejtoria e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Projekteve
 - Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Vlerësimit Institucional
 - Sektori i Projekteve dhe Marrëdhënieve me Jashtë
- Sektori i Kërkimit Shkencor dhe Promovimit Akademik
- Zv. Rektor Akademik
 - Drejtoria e Edukimit për Ciklin e Parë dhe të Dytë
 - Sektori i Kurikulave dhe Shërbimit ndaj Studentëve
 - Sektori i Këshillimit të Karrierës Alumni dhe Aktiviteteve Kulturore Sportive
- Sektori i Bibliotekës Shkencore

- Prof. Asoc. Aurela Saliq Dekan F.SH.
 - Kryesekretare F.SH.
- Prof. Dr. Albert Qarri Dekan F.E.
 - Kryesekretare F.E
- Prof. As. Armela Panajoti Dekan F.SH.H.
 - Kryesekretare F.SH.H
- Prof.As. Hajdar Kicaj Dekan F.SH.T.N.
 - Kryesekretare F.SH.T.N

REKTORI
Prof. Dr. Roland ZISI